



STATUTI LËVIZJA FORCA E DIASPORËS (FeD)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Statut Lëvizja Forca e Diasporës (FeD) përcakton dhe rregullon emrin, emblemën, selinë, përfaqësimin, anëtarësinë, të drejtat dhe përgjegjësitë, format e organizimit dhe të veprimit, procedurat për zgjedhje, format e saj, administrimin, financimin, kushtet për ndërprerjen e veprimtarisë, si dhe çështjet tjera në interes të anëtarëve të saj.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Forca e Diasporës (FeD) është lëvizje liberale e themeluar mbi vlerat kombëtare demokratike dhe universale që bashkon qytetarët brenda dhe jashtë vendit me qëllime të mirëfillta për zhvillim dhe ndryshim pozitiv.
2. Për realizimin e synimeve të saj Lëvizja Forca e Diasporës (FeD) shfrytëzon të gjitha mjetet demokratike parlamentare dhe jo parlamentare.
3. Lëvizja Forca e Diasporës (FeD) bashkëpunon me parti dhe organizime të tjera politike, dhe jo politike si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

Neni 3 Shtrirja Territoriale

1. Shtrirja territoriale arrihet përmes organeve qendrore dhe lokale të Lëvizjes Forca e Diasporës (FeD) të cilat janë të përcaktuara me këtë Statut.
2. Lëvizja Forca e Diasporës (FeD) vepron edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, përmes organizimit të saj në mërgatë.
3. Mënyra e punës, organizimi dhe veprimi jashtë territorit të Republikës së Kosovës rregullohet me Akte të veçanta.

Neni 4

Hierarkia e Akteve

1. Akti më i lart i Lëvizjes së Forcës së Diasporës (FeD) është statuti i saj, ku të gjitha aktet e tjera duhet të jenë në përputhje me Statutin.
2. Statuti i lëvizjes Forca e Diasporës (FeD) si pjesë politike demokratike e cila vepron në Kosovë, duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet në Republikën e Kosovës.
3. Akte të cilat nxjerrjen kanë:
 - a. Rregullore;
 - b. Vendime;
 - c. Udhëzime;
 - d. Rekomandime.

Neni 5

Simbolet

1. Simbolet e Lëvizjes së Forcës së Diasporës (FeD) janë: Flamuri, Emblema dhe logo (simbol identifikues); përdorimi i tyre rregullohet me vendim të veçantë nga kryesia.
2. Lëvizja e Forcës së Diasporës (FeD) e ka vulën e saj në formë elipse në të cilën shkruan Forca e Diasporës (FeD).

Neni 6

Selia

Selia qendrore e Lëvizjes së Forcës së Diasporës (FeD) është në Prishtinë.

Neni 7

Emërtimi dhe Shkurtesat

1. Emërtimi Lëvizja Forca e Diasporës.
2. Shkurtesa- FeD;
3. Lëvizja Forca e Diasporës (FeD) është themeluar me datën 10 gusht, 2019 (dita e saj do të jetë data 10 gusht).

Neni 8

Përfaqësimi

1. Forca e Diasporës (FeD) përfaqësohet nga Kryetari i Lëvizjes Forca e Diasporës (FeD)
2. Kryetari e përfaqëson Forcën e Diasporës (FeD) në të gjitha komunikimet zyrtare, brenda dhe jashtë shtetit të Republikës së Kosovës, po ashtu pranon shkresa zyrtare në emër të Forcës së Diasporës (FeD).
3. Në mungesë të Kryetarit, Forca e Diasporës (FeD) përfaqësohet nga Zëvendës Kryetari.

Neni 9

Misioni

1. Themelimi i Forcës së Diasporës (FeD) ka për mision:
 - a. Bashkimin e potencialit dhe kuadrove jashtëzakonisht të larta intelektuale, politike, ekonomike, kulturore, sportive dhe shoqërore të shqiptarëve nga të gjitha anët e globit, në mënyrë që të angazhojnë kapacitetet e tyre me vullnetin e lirë për të mirën dhe zhvillimin e atdheut, forcimit të diasporës dhe shtetit të së drejtës me demokraci dhe vlera perëndimore;
 - b. Bashkimi dhe koordinimi i gjithanshëm i profesionistëve dhe personave të tjerë, vullnet mirë nga diaspora dhe trojet shqiptare për një zhvillim të qëndrueshëm demokratik, ekonomik, arsimor/shkollor, shëndetësor, social dhe kulturor; stimulim për hulumtime shkencore; forcim të relacioneve ndërkombëtare; tej forcim në procesin e Integrimi Evropiane, përkujdesje institucionale ndaj shportës së qytetarëve; përkujdesje për veteranët e luftës, pensionistët, invalidët dhe personat me nevoja të veçanta, barazi gjinore, etnike, fetare dhe të moshave;
 - c. Përkujdesje ndaj bizneseve në mënyrë që renditja e fitimit të vlerësohet me standardet e Unionit Evropian; tatim të arsyeshëm dhe shpërndarje të fitimit për mirëqenie sociale;
 - d. Angazhim maksimal për rritje ekonomike dhe mundësi inovacioni me qëllim që rinia dhe populli të mbetet në trojet e veta, që do të thotë ulje të emigrimit jashtë;
 - e. Zhvillim të qëndrueshëm mjedisor dhe klimatik në përputhje me konventat evropiane dhe ndërkombëtare;
 - f. Shtet ligjor dhe 100% në përputhje me standardet e BE-së ku respektohen të drejtat e njeriut, dhe siguron qasje më të mirë në drejtësi për të gjithë qytetarët. Rishikimi i tërë infrastrukturës ligjore që rregullon fushën e sundimit të ligjit në bashkëpunim me përfaqësues nga Bashkimi Evropian.

II. ANËTARËSIA

Neni 10

Anëtarësia në Forcën e Diasporës (FeD)

1. Anëtarë i Forcës së Diasporës (FeD) mund të bëhet çdo qytetarë nga moshë 18 vjeç, pa dallim feje, race, gjinie dhe orientimit seksual i/e cili e pranon Programin dhe Statutin e saj.
2. Anëtarësia bëhet me deklaram të lirë në formë të shkruar, në degët e territorit të Republikës së Kosovës dhe jashtë saj (të gjithë mërgimtarët të cilët posedojnë nënshtetësinë e Kosovës).
3. Regjistrimi në Lëvizjen e Forcës së Diasporës (FeD) e mbajnë degët dhe kryesia e saj.
4. Mbajtja e regjistrimit dhe mënyra e lëshimit të kartelave për anëtarësinë rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 11

Të Drejtat e Anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD)

1. Anëtari i Forcës së Diasporës (FeD) ka të drejtat si në vijim:

- a. Secili anëtarë në Lëvizjen e Forcës së Diasporës (FeD) është i obliguar që të paguaj anëtarësinë vjetore në mënyrë të rregullt;
 - b. Të zgjedh dhe të zgjidhet në organet e Forcës së Diasporës (FeD);
 - c. Të jetë pjesëmarrës në aktivitetet e Forcës së Diasporës (FeD) në mënyrë të barabartë;
 - d. Të shpreh lirshëm mendimet brenda organeve të lëvizjes;
 - e. Të shfaq propozime dhe të afrojmë nisma në përputhshmëri me Statutin e lëvizjes;
 - f. Anëtari i Forcës së Diasporës (FeD) ka për detyrë t'i përmbahet programit dhe Statutit të lëvizjes;
 - g. Ta ruaj nderin, autoritetin dhe interesat e lëvizjes;
 - h. Të përpiqet për suksesin e Forcës së Diasporës (FeD) në Fushata Zgjedhore;
 - i. Të paguaj anëtarësinë dhe të përmbush detyrimet e tjera në përputhshmëri me statutin dhe dokumentacionet e tjera;
 - j. Çdo anëtarë ka të drejtë të jetë kandidat për zgjedhjet qendrore dhe lokale.
2. Anëtari duhet të pajiset me kartelë identifikuese se është anëtar i Forcës së Diasporës (FeD), dhe të deklarojë se e pranon Statutin dhe Programin Politik të Forcës së Diasporës (FeD).
 3. Forma e kartelës, vlera dhe lartësia e taksës së anëtarësisë do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Përgjithshëm;
 4. Askush nuk mundet të realizoj të drejta shtesë në Forcën e Diasporës (FeD) përmes dhurimit dhe donacioneve financiare.

Neni 12

Kontributi dhe përkushtimi i çdo anëtari të Forcës së Diasporës (FeD) është rritja e anëtarësisë dhe votave në të gjitha nivelet.

Neni 13

Detyrat e Anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD)

1. Çdo anëtar i Forcës së Diasporës (FeD) ka për detyrë:
 - a. T'i përmbahet Programit dhe Statutit të Lëvizjes së Forcës së Diasporës (FeD);
 - b. Të respektojë dhe zbatojë vendimet dhe objektivat e Forcës së Diasporës (FeD);
 - c. Ta ruajë autoritetin dhe interesat e Forcës së Diasporës (FeD);
 - d. Të punojë me përkushtim për suksesin e Lëvizjes së Forcës së Diasporës (FeD) në fushata zgjedhore;
 - e. Të paguajë anëtarësinë dhe të përmbushë detyrimet e tjera në pajtim me këtë Statut dhe dokumentet e tjera.

Neni 14

Pushimi i të Drejtës të një Anëtari nga Forca e Diasporës (FeD)

1. E drejta për të qenë anëtarë në Lëvizjen e Forcës së Diasporës (FeD) pushon:
 - a. Me vdekjen e anëtarit;
 - b. Dorëheqja nga anëtarësia në Forcën e Diasporës (FeD);

- c. Anëtarësimi dhe përfshirja në listën e ndonjë subjekti tjetër politik;
 - d. Përrjashtim nga Forca e Diasporës (FeD);
2. Me pushimin e të drejtës për të qenë anëtarë i Forcës së Diasporës (FeD), anëtarë tërrhiqet nga Regjistri i Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 15

Dorëheqja e Anëtarit nga Forca e Diasporës (FeD)

1. Anëtarë, dorëheqjen e tij/saj nga anëtarësia e Forcës së Diasporës (FeD) mund ta paraqes me shkrim tek koordinatori i degës në vendin apo komunën ku ai/ajo jeton.
2. Me kërkesën e tij/saj mund të lëshohet vendimi me shkrim nga koordinatori i degës.
3. Anëtarë i dorëhequr detyrohet të dorëzojë kartelën e anëtarësimit dhe emri i tij/saj të tërrhiqet nga Regjistri i Anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 16

Përrshtimi i një Anëtarë nga Forca e Diasporës (FeD)

1. Një anëtarë mund të përrshtohet nga Forca e Diasporës (FeD) nëse:
 - a. Vepron në kundërrshtim me Programin dhe Statutin e Forcës së Diasporës (FeD), dhe me sjelljet e tij/saj dëmton interesat e Forcës së Diasporës (FeD);
 - b. Vepron kundër anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD);
 - c. Përrkrah subjektet tjera politike në zgjedhje;
 - d. Nuk paguan anëtarësinë për dy vite radhazi.

Neni 17

Masat Disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj një anëtarë të Forcës së Diasporës (FeD) i shqipton Komisioni Disiplinor.
2. Anëtarët e Forcës së Diasporës (FeD) kanë të drejtë ankese ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor, dhe mundën të dërgojnë ankesën në Kryesinë e Lëvizjes. Vendimi i Kryesisë është vendim përrfundimtar.

III. ORGANIZIMI DHE ORGANET E FORCËS SË DIASPORËS (FED)

Neni 18

Organet Përrgjegjëse

1. Organet përrgjegjëse të Forcës së Diasporës (FeD) janë:
 - a. Kuvendi;
 - b. Këshilli i Përrgjithshëm;
 - c. Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD);
 - d. Kryesia;
 - e. Komisioni Statutor;
 - f. Komisioni mbikëqyrës i financave;

- g. Komisioni disiplinor;
 - h. Sekretari i përgjithshëm;
 - i. Koordinatorët e degëve në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe jashtë saj.
2. Të gjitha organet e Forcës së Diasporës (FeD) zgjedhën për një mandat katër (4) vjeçar.
 3. Forca e Diasporës (FeD) ka departamentet e veta të cilat funksionojnë si organe profesionale në sektorë të veçantë, të cilët zgjidhen nga Këshilli i Përgjithshëm i Forcës së Diasporës (FeD), si dhe administratën e cila është në funksion dhe shërbim të saj.

Neni 19

Kuvendi

1. Kuvendi është organi më i lartë i Forcës së Diasporës (FeD).
2. Kuvendi ka 400 delegat të zgjedhur në kuvendet e degëve brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe jashtë saj, ku 250 delegat janë shtetas të Republikës së Kosovës të cilët kanë vendqëndrim jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe 150 delegat të cilët janë shtetas të Kosovës dhe kanë vendqëndrim në territorin e Republikës së Kosovës.
3. Delegatët e Kuvendit të cilët kanë vendqëndrim jashtë territorit të Republikës së Kosovës do të përfaqësohen në Kuvend duke marrë parasysh numrin e anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD): çdo 100 anëtarë të Forcës së Diasporës (FeD) në vendin ku jetojnë përfaqësohen me nga një (1) delegat në Kuvend.
4. Delegatët e Kuvendit të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe kanë vendqëndrim në territorin e Kosovës do të përfaqësohen në Kuvend duke marrë parasysh numrin e anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD); çdo 150 anëtarë të Forcës së Diasporës (FeD) në komuna të Kosovës përfaqësohen me nga një (1) përfaqësues në Kuvend.
5. Për numrin e delegatëve sipas degëve dhe kriteret e zgjedhjeve të tyre vendos Këshilli i Përgjithshëm, përkatësisht kryesia e Forcës së Diasporës (FeD) në bazë të autorizimit të Këshillit të përgjithshëm.
6. Me rastin e zgjedhjes së delegatëve për Kuvend çdo degë e Forcës së Diasporës (FeD) siguron përfaqësimin vajzave/grave, të rinjve si dhe personave me aftësi të kufizuara.
7. Çdo vit, Kuvendi në javën e fundit të muajit nëntor mbanë mbledhjen e përgjithshme të rregullt.
8. Në mbledhjen e përgjithshme të rregullt të Kuvendit, ju ofrohet mundësia të marrin pjesë anëtarëve të cilët nuk janë delegatë në Kuvend, si dhe mërgimtarëve dhe simpatizantëve të cilët nuk janë anëtarë të Forcës së Diasporës (FeD), por pa të drejtë diskutimi dhe vote në mbledhje të Kuvendit, dhe pa të drejtë që të kandidojnë për të përfaqësuar ndonjë organ apo të jenë pjesë e listave zgjedhore.
9. Në punën e Kuvendit marrin pjesë edhe anëtarë aktual të Kryesisë dhe të këshillit të përgjithshëm të Forcës së Diasporës (FeD), por pa të drejtë vote nëse nuk janë zgjedhur delegat të Kuvendit.
10. Në rast të vdekjes apo dorëheqjes të një delegati të Kuvendit, ai/ajo zëvendësohet automatikisht me delegatin tjetër nga vendqëndrimi nga ku ka qenë delegati i/e vdekur apo dorëhequr.

Neni 20

Procedurat për Mbajtjen e Mbledhjes së Kuvendit

1. Kuvendi mbanë sesione plenare dhe sesione pune.
2. Sesionet plenare të Kuvendit organizohen çdo katër (4) vjet në mbledhjen e rregullt të përgjithshme të Kuvendit dhe kanë për qëllim zgjedhjen e organeve të Forcës së Diasporës (FeD).
3. Sesionet e punës mbahen sipas nevojës ose çdo vit.
4. Sesionet e punës së Kuvendit janë ato në të cilat kërkohet vendimmarrja për nxjerrjen e akteve normative të Forcës së Diasporës (FeD), dhe vendimmarrje për çështje tjera të rëndësishme në Forcën e Diasporës (FeD). Këto sesione përveç në mbledhjen e rregullt të përgjithshme të Kuvendit mund të jenë edhe sesione në mbledhjet e jashtëzakonshme të Forcës së Diasporës (FeD).
5. Kuvendi mund të mbajë mbledhje edhe kur kërkohet nga 1/3 (një e treta) e delegatëve si brenda dhe jashtë territorit të Kosovës që e përbëjnë Kuvendin.
6. Kuvendi i thirrur nga 1/3 mbahet në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita kur është pranuar kërkesa me shkrim nga Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD).
7. Për mbledhjet e përgjithshme të jashtëzakonshme, njoftimi bëhet dhjetë ditë (10) para mbajtjes së mbledhjes.
8. Mbledhja e rregullt e Kuvendit do të jetë dy ditore dhe në rend dite mund të propozohen edhe pika tjera të cilat mund të konsiderohen të nevojshme të shqyrtohen në mbledhje, dhe për të cilat voton shumica (50% + 1) e delegatëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje.
9. Materialet dhe dokumentet tjera të cilat diskutohen në mbledhjen e Kuvendit duhet të dorëzohen së bashku me rendin e ditës.

Neni 21

Përgjegjësitë e Kuvendit

1. Kuvendi ka përgjegjësi:
 - a. Miraton, ndryshon, dhe plotëson programin e statutit të Forcës së Diasporës (FeD);
 - b. Përcakton orientimet themelore të veprimit politik të Forcës së Diasporës (FeD);
 - c. Të nxjerr rezoluta, deklarata dhe merr vendime;
 - d. Të zgjedh Kryetarin e Forcës së Diasporës (FeD);
 - e. Të zgjedh anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të Forcës së Diasporës (FeD) sipas dispozitave të këtij Statuti;
 - f. Me propozim të Kryesisë zgjedh anëtarët e Komisionit Statutor, Komisioni Mbikëqyrës të Financave dhe Komisionin Disiplinor;
2. Kuvendi nxjerrë Rregullore të veçantë për punën dhe procedurat e punës së Kuvendit.

Neni 22

Kuorumi

1. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme në çoftë se në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e delegatëve të zgjedhur të Kuvendit dhe nëse për to votojnë shumica e pranishme;

2. Përveç zgjedhjes së organeve të Forcës së Diasporës (FeD) të cilat zgjidhen me votim të fshehtë, vendimet tjera në Kuvend merren me votime të hapura.

Neni 23

Vendimet për Zgjedhjen e Organeve

1. Vendimet për zgjedhjen e organeve të Forcës së Diasporës (FeD), konsiderohen të vlefshme nëse në mbledhjen e këtyre organeve: Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm, Kryesisë, marrin pjesë shumica e anëtarëve të këtyre organeve dhe votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm.
2. Vendimet e marra sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk vlejnjë për shpërbërjen e Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 24

Këshilli i Përgjithshëm

1. Këshilli i Përgjithshëm është organ drejtues i cili ka 15 anëtarë. Përfaqësimi 50% duhet të jenë nga gjinia femrore.
1. Anëtarë në Këshillin e Përgjithshëm janë: Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm (Kryetari i FeD-it), Zëvendës Kryetari, anëtarët e Kryesisë (4) dhe nëntë (9) anëtarë të cilët zgjidhen me propozimin dhe votat e anëtarëve të Kuvendit.
2. Puna dhe funksionimi i Këshillit të Përgjithshëm rregullohen me Rregullore të veçantë, që miratohet nga Këshilli Përgjithshëm.
3. Këshilli i Përgjithshëm mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
4. Mbledhjet e rregullta të Këshillit të Përgjithshëm mbahen së paku një herë në tre muaj dhe kryesohet nga Kryetari.
5. Mbledhjet e Këshilli të Përgjithshëm i fton Kryetari dhe 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.
6. Për mbajtjen e mbledhjes së rregullt, anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm duhet të njoftohen shtatë ditë (7) përpara. Për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit të Përgjithshëm anëtarët duhet të njoftohen dy ditë (2) përpara.
7. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit të Përgjithshëm mbahen nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve (50% +1).
8. Vendimet e Këshillit të Përgjithshëm merren më shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje (50% +1).
9. Procedurat për humbjen e të drejtës së anëtarit të Kuvendit vlejnjë edhe për humbjen e të drejtës së anëtarit të Këshilli të Përgjithshëm.

Neni 25

Përgjegjësitë e Këshillit të Përgjithshëm

1. Përgjegjësitë e Këshillit të Përgjithshëm janë:
 - a. Jep propozimet për ndryshim apo plotësim të Programit dhe Statutit të Forcës së Diasporës (FeD)t;
 - b. Miraton Rregulloren për punën e vet dhe planin e punës;
 - c. Miraton Programin dhe Platformën Zgjedhore;

- d. Zgjedh Shtabin Qendror Zgjedhor të Forcës së Diasporës (FeD);
- e. Zgjedh Drejtorët e Departamenteve për të cilat funksionojnë si organe profesionale në sektorë të veçantë, si dhe administratën e cila është në funksion dhe shërbim të Forcës së Diasporës (FeD);
- f. Miraton listën e kandidatëve për zgjedhje;
- g. Vendos për lidhjen e koalicioneve para dhe pas zgjedhjeve;
- h. Kryen punë të tjera në pajtim me dispozitat e këtij statuti;
- i. Me propozim të Kryetarit zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë, nënkryetarët dhe Sekretarin e Përgjithshëm;
- j. Me propozim të Kryesisë së Forcës së Diasporës (FeD), përcakton Kandidatin për President dhe për Kryeministër nga radhët e Forcës së Diasporës (FeD).
- k. Në bazë të listës initiale të degëve, pas propozimit të Kryesisë, përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të Forcës së Diasporës (FeD) për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- l. Me propozim të kandidatit për kryeministër, miraton anëtarët e kabinetit qeveritar;
- m. Merr vendim për zgjedhjet në Forcën e Diasporës (FeD);
- n. Vendos për pjesëmarrje të Forcës së Diasporës (FeD) në qeverisjen qendrore;
- o. Vendos për anëtarësim në organizatat vendore dhe ndërkombëtare;
- p. Ndjek realizimin e politikës së Forcës së Diasporës (FeD) nga ana e përfaqësuesve të saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në organet e tjera të pushtetit;

Neni 26

Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD)

1. Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD) është njëkohësisht edhe Kryetari i Kuvendit të Përgjithshëm i Forcës së Diasporës (FeD), Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm dhe Kryetar i Kryesisë.
2. Kryetarin e Forcës së Diasporës (FeD) e zgjedh Kuvendi i Përgjithshëm me shumicë votash me një mandat prej katër (4) vjeçar.
3. Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD) i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Përgjithshëm.
4. Kryetari vepron dhe punon në përputhje me rregullat që i miraton Kuvendi i Përgjithshëm;
5. Kryetari apo delegatët e Kuvendit propozojnë kandidatin për zv. Kryetarin, anëtarët e Këshillit dhe anëtarët e Kryesisë.
6. Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend. Secila kandidaturë duhet të miratohet me shumicë votash (50 % +) e delegatëve të pranishëm.
7. Në rast se Kuvendi nuk aprovon më shumë se një kandidaturë për pozitën e Kryetarit, atëherë Kuvendi vendos për mënyrën e përzgjedhjes dhe votimit për Kryetar;
8. Kryetari njëkohësisht është Kryetar i Kuvendit, i Këshillit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë së Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 27

Kryesia

1. Kryesia është organ politiko-ekzekutiv i Këshillit të Përgjithshëm të Forcës së Diasporës (FeD).
2. Përfaqësuesit e Kryesisë janë:

- a. Kryetari i Fed-it;
 - b. Koordinatori i Kosovës;
 - c. Kryetari i Forumit për Barazi Gjinore;
 - d. Kryetari i Rrjetit të Biznesit së Diasporës;
 - e. Kryetari i Forumit Rinor;
3. Kryesinë e zgjedh Këshilli i Përgjithshëm i Forcës së Diasporës (FeD).
 4. Kryesia drejton politikat e veprimtarisë dhe aktiviteteteve të Forcës së Diasporës (FeD) brenda katër (4) viteve.
 5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesisë janë:
 - a. Themelon shtabet dhe drejton fushatën parazgjedhore;
 - b. Zhvillon aktivitete tjera në përputhje me statutin e Forcës së Diasporës (FeD).
 - c. I propozon anëtarët e Komisionit Statutor, Komisionit Mbikëqyrës të Financave dhe Komisionit Disiplinor;
 - d. I propozon Këshillit të Përgjithshëm themelimin e degëve të reja koordinuese për vende të caktuara;
 - e. I propozon Këshillit të Përgjithshëm për koalicione para dhe pas zgjedhore në nivel lokal dhe qendror;
 - f. Paraqet raport vjetor të punës në Këshillin e Përgjithshëm;
 - g. Paraqet të dhëna mbi pasurin e Forcës së Diasporës (FeD);
 - h. Paraqet Raport Financiar një herë në vit Këshillit të Përgjithshëm;
 - i. Vendos për dhënie të falënderimeve dhe të mirënjohjeve për merita e rezultate të punës;
 - j. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me Programin dhe me Statutin e Forcës së Diasporës (FeD).
 6. Për punën dhe procedurën e punës, Kryesia nxjerr Rregullore e cila miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm.

Neni 28

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës:
 - a. Kujdeset për organizimin e punës së Kryesisë;
 - b. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, të Këshillit të Përgjithshëm, të Kryetarit, dhe të Kryesisë së Forcës së Diasporës (FeD), si dhe udhëheq shërbimet profesionale;
 - c. Nënshkruan dokumentet operative financiare;
 - d. Kujdeset për përdorimin e vulave për të gjitha nivelet organizative;
 - e. Administron pasurinë në shfrytëzim;
 - f. Përcjell pagesat e anëtarësisë dhe për këtë i raporton Kryesisë së Forcës së Diasporës (FeD);
 - g. Nënshkruan kontrata;
 - h. Organizon dhe bashkërendit punën e degëve të lëvizjes dhe për këtë i raporton Kryetarit dhe Kryesisë së Forcës së Diasporës (FeD);
 - i. Kryen dhe punë të tjera, të cilat i parashtron Kryetari, Këshilli i Përgjithshëm dhe Kryesia i Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 29

Koordinatorët në vende të ndryshme të botës dhe Degët Koordinuese në Komunitet e Republikës së Kosovës

1. Në të gjitha shtetet në të cilat Forca e Diasporës (FeD) ka shtrirje territoriale përfaqësimi bëhet nga Koordinator i cili njëkohësisht është përfaqësues i degës në atë shtet.
2. Në Komunitet e Kosovës në të cilat Forca e Diasporës (FeD) ka shtrirje territoriale Koordinator në atë Komunitet është përfaqësues i Degës.
3. Varësisht prej numrit të anëtarëve dhe simpatizantëve, Kryesia mund të hap Zyre Koordinuese në një shtet apo komunitet.
4. Përgjegjësitë e Koordinatorëve janë:
 - a. Mban evidenca për anëtarët e rinj në Forcën e Diasporës (FeD);
 - b. I propozojnë kryesisht me shkrim për kërkesa të ndryshme të bëra nga anëtarët e Forcës së Diasporës (FeD) për ndryshime në Statut apo për rregullore në favor të Forcës së Diasporës (FeD).
 - c. Përgjigjet drejt për së drejti për grumbullimin e pagesave të anëtarësisë dhe raportimin e tyre tek Kryesia me shkrim;
 - d. Kryen punë të tjera të deleguara nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryesia.

Neni 30

Komisioni Statutor

1. Komisioni statutor është organi përfundimtar për interpretimin e Statutit të Forcës së Diasporës (FeD).
2. Vendimi i komisionit statutor për interpretim të statutit është përfundimtarë.
3. Komisionit statutor ka pesë (5) anëtarë që zgjedhën nga Kuvendi me votim të fshehtë, pas propozimit të listës përfundimtare e cila bëhet nga Kryesia.
4. Komisioni statutor merr vendime me shumicë të thjeshtë dhe mban mbledhje, sipas nevojës dhe pas paraqitjes së rasteve për interpretim të statutit.
5. Mënyra e punës dhe procedurat e funksionimit të këtij komisioni rregullohen me vendim të veçantë i cili nxjerrët nga Kuvendi.

Neni 31

Komisioni Mbikëqyrës i Financave

1. Komisioni Mbikëqyrës i Financave është organ mbikëqyrës i Forcës së Diasporës (FeD), i cili zgjidhet për katër (4) vjet.
2. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët i zgjedh Kuvendi.
3. Komisioni Mbikëqyrës kontrollon të hyrat financiare të Forcës së Diasporës (FeD), shpërndarjen e tyre dhe menaxhimin me pronën në shfrytëzim të Forcës së Diasporës (FeD).
4. Komisioni Mbikëqyrës për kontrollin e brendshëm i raporton Kuvendit.
5. Me vendimin për themelimin e këtij komisioni të përcaktohen edhe rregullat dhe procedurat e punës së këtij Komisioni.

Neni 32
Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët i zgjedhë Kuvendi.
2. Për punën e vetë, Komisioni Disiplinor i raporton Kuvendit.
3. Mënyra e funksionimit dhe fushëveprimi i Komisionit rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Kuvendi.

Neni 33
Organizimi i Departamenteve

1. Forca e Diasporës (FeD) duke pasur parasysh organizimin e funksionimit profesional, ndanë ekspertizën profesionale dhe përgjegjësin e anëtarëve profesional në departamentet si në vijim:
 - a. Departamenti për Drejtësi dhe Punë të Brendshme;
 - b. Departamenti Diplomatik dhe Lobues;
 - c. Departamenti për Integritet Evropian;
 - d. Departamenti i Komunikimit dhe Informimit;
 - e. Departamenti i Shkencës, Arsimit, dhe Inovacionit;
 - f. Departamenti i Shëndetësisë dhe Konsumatorëve;
 - g. Departamenti i Biznesit dhe Investimeve;
 - h. Departamenti i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - i. Departamenti i Rinis, Kulturës, Artit, dhe Sportit;
 - j. Departamenti i Bujqësisë, Ambientit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
 - k. Departamenti i Turizmit dhe Bashkëpunimit Rajonal;
 - l. Departamenti për Barazi Gjinore, të Drejta të Njeriut dhe Demokraci.
2. Të gjithë departamentet do të përfaqësohen nga ekspertët e diasporës dhe ekspertët vendor, duke respektuar përfaqësimin e barabartë gjinor, si dhe përfaqësues nga personat me nevoja të veçanta.
3. Për punën dhe funksionimin e Departamenteve, Këshilli i Përgjithshëm nxjerr rregullore të veçantë.

IV. FINANCIMI

Neni 34
Financimi

1. Financimi bëhet nga anëtarësia dhe donacionet.
2. Financimi bëhet nga buxheti i shtetit sipas legjislacionit për financimin e partive politike.
3. Raportet financiare dhe mënyra e financimit bëhen publike për anëtarët e Forcës së Diasporës (FeD) dhe organeve të saj. Raporti përfundimtarë për financimin e Forcës së Diasporës (FeD) miratohet nga Kryesia e Forcës së Diasporës (FeD).

4. Kompetent për të kontrolluar financat e Forcës së Diasporës (FeD) është komisioni mbikëqyrës i financave i themeluar nga Kuvendi.

Neni 35

Shuarja e Forcës së Diasporës (FeD) dhe Bashkimi me Subjektet tjera

1. Forca e Diasporës (FeD) mund të pushojë së ekzistuari apo të bashkohet me ndonjë subjekt tjetër nëse për këtë vendosin $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e të gjithë delegatëve të Kuvendit në mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit.
2. Me rastin e shuarjes apo bashkimit me subjekt tjetër, së pari përmbushen të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve.
3. Në rast të shuarjes së Forcës së Diasporës (FeD) me vendim të posaçëm të Kuvendit, mjetet e mbetura shpërndahen në organizata humanitare të Republikës së Kosovës.

Neni 36

Periudha e Raportimit dhe Viti Financiar

1. Deri me 31 mars, Drejtorët e Departamenteve duhet të paraqesin raporte vjetore para Këshillit të përgjithshëm të Forcës së Diasporës (FeD) për aktivitetet e vitit paraprak.
2. Viti financiar i Forcës së Diasporës (FeD) do të përputhet me vitin kalendarik.

V. INFORMIMI DHE SHËRBIMET ADMINISTRATIVE

Neni 37

Informimi

1. Anëtarët e Forcës së Diasporës (FeD) kanë të drejtë të informohen në mënyrë objektive dhe me kohë për vendimet e të gjitha organeve drejtuese.
2. Informimi i anëtarëve të Forcës së Diasporës (FeD) bëhet nëpërmjet formave të brendshme të informimit dhe organeve të veta të cilat publikojnë vendimet dhe qëndrimet e veta të marra nga organet drejtuese në të gjitha nivelet.
3. Kryesia miraton Rregullore për organizimin, procedurat dhe funksionimin e informimit.

Neni 38

Shërbimi Administrativë

1. Për punët e përditshme Forca e Diasporës (FeD) angazhon stafin administrativë.
2. Struktura dhe përgjegjësitë e stafit administrativë përcaktohen në Rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm.
3. Kompensimi për punën e stafit administrativë bëhet nga buxheti i Forcës së Diasporës (FeD).

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 39

Amendamenti i Statutit

1. Amendamenti i statutit bëhet nga Kuvendi në mbledhjen e rregullt me 2/3 e votave të delegatëve të cilët janë prezent në mbledhje.
2. Propozues të amendamenteve në statut janë:
 - a. 1.Këshilli i Përgjithshëm;
 - b. 1/3 e delegatëve të Kuvendit;
 - c. Kryetari;
 - d. Kryesia.

Neni 40

Interpretimi

Në rast se paraqitet vështirësi në zbatimin pra të një dispozite të statutit, interpretimi i komisionit statutor është përfundimtar dhe i obligueshëm për të gjitha organet e Forcës së Diasporës (FeD).

Neni 41

Tranzicioni dhe Rregulloret e Reja

1. Kryesia cakton një komision ad-hoc, për hartimin e rregulloreve të reja që dalin pas miratimit të këtij statuti
2. Obligohet Kryesia që brenda 30 ditëve pas miratimit të këtij Statuti ta publikojë atë.

Neni 42

Hyrja në Fuqi

Ky statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi

Kryetari i Forcës së Diasporës (FeD)
Emri dhe mbiemri

Datë: